



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I MBIKËQYRJES FINANCIARE
BORDI

RREGULLORE

PËR
FORMËN DHE PROCEDURËN E REGJISTRIMIT TË AKTOFERTËS PËR EMETIMIN
E TITUJVE TË BORXHIT

Miratuar me Vendimin e Bordit nr. 61, datë 29.04.2025

Neni 1

Qëllimi i rregullores

Qëllimi i kësaj rregulloreje është përcaktimi i:

1. Formës së aktofertës për ofertat e titujve të borxhit që janë të përjashtuara nga përgatitja e prospektit të plotë, sipas parashikimit të nenit 244 të Ligjit nr. 62, datë 14.5.2020 “Për Tregjet e Kapitalit”.
2. Procedurës për regjistrimin e aktofertës për emetimin e titujve të borxhit.

Neni 2

Baza ligjore

Kjo rregullore hartohet në zbatim të pikës 2, të nenit 14, të Ligjit nr. 9572, datë 03.07.2006 “Për Autoritetin e Mbikëqyrjes Financiare”, i ndryshuar, si dhe pikave 2 dhe 4, të nenit 248, të Ligjit nr. 62, datë 14.05.2020 “Për Tregjet e Kapitalit”.

Neni 3

Përkufizime

1. Në kuptim të kësaj rregulloreje:
 - a) “Tituj të borxhit” janë tipet e ndryshme të obligacioneve ose forma të tjera të borxhit afatshkurtër apo borxhit të titullzuar, si dhe obligacione ose borxhe të konvertueshme në tituj, apo që përfshijnë një instrument derivativ ose kanë një strukturë komplekse.
 - b) “Aktofertë bazë” është dokumenti i përgatitur sipas nenit 20, të rregullores.
 - c) “Transh” është një pjesë e programit të emetimit të aktofertës bazë, i cili përfaqëson një titull borxhi të identifikuar me numrin përkatës kombëtar/ndërkombëtar ISIN.
2. Termat e tjera të përdorura në këtë rregullore kanë të njëjtin kuptim me ato të parashikuara në Ligjin nr. 62/2020 “Për Tregjet e Kapitalit”, referuar në këtë rregullore si “ligji”.

Neni 4

Fusha e zbatimit

Kjo rregullore zbatohet nga emetuesi me seli në Republikën e Shqipërisë apo jashtë saj, për ofertën e titujve të borxhit, të përjashtuar nga përgatitja e prospektit të plotë, në kuptim të nenit 244, të ligjit.

Neni 5

Përjashtime nga zbatimi i rregullores

Përjashtohen nga zbatimi i kësaj rregulloreje emetuesit e titujve të borxhit, sipas parashikimeve të nenit 245, të ligjit.

Neni 6

Rastet e përgatitjes së aktofertës

Aktoferta për emetimin e titujve të borxhit, si dokument i ndryshëm nga prospekti, përgatitet për rastet si më poshtë:

- a) Për ofertën e titujve të borxhit, e cila u drejtohet vetëm palëve të pranueshme, investitorëve profesionistë dhe/ose të kualifikuar;
- b) Për ofertën e titujve të borxhit, e cila u drejtohet më pak se 100 investitorëve të ndryshëm nga investitorët e përcaktuar në shkronjën “a”, të kësaj pike, të përlogaritur në numër total, përgjatë një periudhe 12-mujore;
- c) Për ofertën e titujve të borxhit, kur vlera për njësi e titullit është të paktën 6 000 000 lekë, 50 000 euro ose 50 000 USD;
- ç) Për ofertën e titujve të borxhit, e cila u jepet vetëm klientëve që blejnë tituj me një vlerë të paktën 6 000 000 lekë, 50 000 euro ose 50 000 USD për klient, për çdo ofertë veçmas;
- d) Për titujt e borxhit të ofruara, që u janë shpërndarë apo që do t’u shpërndahen anëtarëve ekzistues ose të mëparshëm të organeve drejtuese ose punonjësve ekzistues ose të mëparshëm, nga punëdhënësi i tyre ose nga një shoqëri e lidhur me të, me kusht që të vihet në dispozicion një dokument, i cili përmban informacion për numrin, natyrën e titujve të borxhit, arsyet si dhe detajet e ofertës ose shpërndarjes;
- dh) Për titujt e borxhit të emetuara në mënyrë të vazhdueshme ose të përsëritur nga një bankë, kur shuma totale agregate e titujve të borxhit të ofruar është më e vogël se 8 miliardë lekë për bankë, e llogaritur për një periudhë 12 mujore, me kusht që këto tituj:
 - i. Të mos jenë të nënrenditur (borxh i varur), të konvertueshëm ose të këmbyeshëm;
 - ii. Të mos japin të drejtë për të nënshkruar ose blerë lloje të tjera titujsh dhe të mos jenë të lidhur me një instrument derivativ.
- e) Për ofertën e titujve të borxhit me vlerë totale më të vogël se 130 000 000 lekë, e llogaritur gjatë një periudhe 12 mujore.

Neni 7

Forma dhe përmbajtja e aktofertës

1. Forma dhe përmbajtja e aktofertës do të jetë sipas shtojcës 1, të kësaj rregulloreje.
2. Në rastin e aktofertës bazë, do të zbatohen kërkesat e përcaktuara në nenin 20, të kësaj rregulloreje.

Neni 8

Numri kombëtar/ndërkombëtar i identifikimit të titullit të borxhit

1. Çdo titull borxhi që emetohet përmes një aktoferte, identifikohet me numrin kombëtar/ndërkombëtar të identifikimit “ISIN”.
2. Në të njëjtën aktofertë nuk mund të përfshihen tituj me numra kombëtar/ndërkombëtar të identifikimit “ISIN” të ndryshëm.
3. Në rastin e përgatitjes së aktofertës bazë, numri kombëtar/ndërkombëtar i identifikimit “ISIN” përcaktohet për çdo titull në termat përfundimtare sipas përcaktimeve të nenit 20, të kësaj rregulloreje.

Neni 9

Dokumentacioni që shoqëron aktofertën

1. Aktoferta shoqërohet nga:
 - a) Kërkesa për regjistrimin e aktofertës, sipas formularit të kërkesës së paraqitur në shtojcën 3, të kësaj rregulloreje;
 - b) Vërtetimi i gjendjes gjyqësore të administratorit dhe të anëtarëve të këshillit mbikëqyrës/administrimit;
 - c) Vendimi i organit kompetent për ofertën e titujve të borxhit;
 - d) numri i investitorëve potencialë, në rastin e ofertës së parashikuar në shkronjën b, të nenit 6, të kësaj rregulloreje;
 - e) Letër konfirmimi/miratimi nga autoriteti kompetent rregullator i vendit të origjinës së emetuesit (sipas rastit);
 - f) Marrëveshja më e fundit me shoqërinë audituese/audituesin ligjor;
 - g) Formulari i kërkesës për investim në një emetim të ri titujsh borxhi, sipas shtojcës 4, të kësaj rregulloreje;
 - h) Deklarata tip për njohjen e rreziqeve nga investitori, sipas shtojcës 6, të kësaj rregulloreje;
 - i) Testi i përshtatshmërisë për rastet e parashikuara në Ligj;
 - j) Draftkontrata/marrëveshja me klientin për nënshkrimin e titullit të borxhit;
 - k) Njoftimi tip për thirrjen e mbledhjes së zotëruesve të titujve të borxhit;
 - l) Dokument që vërteton kryerjen e pagesës ndaj Autoritetit, për trajtimin e kërkesës së regjistrimit.
2. Kërkesa e parashikuar në shkronjën “b”, të pikës 1, të këtij neni, nuk zbatohet për aktofertën e përgatitur nga një subjekt financiar i mbikëqyrur.
3. Në kuptim të rregullores në fuqi “Për përcaktimin e elementeve të përlllogaritjes dhe nivelet e tarifave që u ngarkohen subjekteve të mbikëqyrura”, si dhe procedurat e arkëtimit dhe rakordimit të tyre, tarifa për regjistrimin e aktofertës, në rastin e një programi emetimi të përfaqësuar nga aktoferta bazë, do të zbatohet për regjistrimin e aktofertës bazë dhe për çdo emetim.

Neni 10

Njoftime për investitorin në aktofertë

1. Aktoferta duhet të përmbajë disa njoftime të rëndësishme për investitorin në lidhje me:
 - a) Përgjegjësinë e Autoritetit, ku theksohet se Autoriteti verifikon nëse aktoferta përmban të gjithë informacionin e kërkuar sipas ligjit dhe kërkesave rregullatore, por nuk

verifikon saktësinë apo vërtetësinë e informacioneve të paraqitura në aktofertë. Autoriteti nuk bën asnjë rekomandim për përshtatshmërinë e investimit në tituj borxhi për asnjë person;

- b) Përgjegjësinë e emetuesit, ku përfaqësuesi i emetuesit deklaron se të gjitha të dhënat që përmbahen në aktofertë përbëjnë paraqitje të plotë dhe të vërtetë të aktiveve dhe pasiveve, fitimeve dhe humbjeve, gjendjes financiare dhe operacioneve të emetuesit, të drejtave të lidhura me titullin e borxhit për të cilin është përgatitur aktofertra dhe se nuk janë hequr fakte dhe të dhëna të cilat mund të ndikonin në plotësinë dhe vërtetësinë e aktofertës;
- c) Përgjegjësinë e investitorit, ku vihet në dukje se çdo investitor mban përgjegjësi për vendimin e tij mbështetur në informacionet që përmban aktofertra dhe, nëse nuk është i bindur për investimin, mund të konsultohet me një profesionist të fushës.

- 2. Njoftimet e parashikuara në pikën 1, të këtij neni, duhet të përfshihen në hyrje të çdo aktofertra.

Neni 11

Faktorët e rrezikut në aktofertë

- 1. Faktorët e rrezikut, të paraqitur në aktofertë, kufizohen minimalisht në rreziqet specifike të emetuesit dhe titullit që do të emetohet.
- 2. Faktorët e rrezikut në aktofertë duhet të:
 - a) Shprehen qartë dhe saktë;
 - b) Kenë përmbajtje konkrete;
 - c) Evidentohen dukshëm;
 - d) Përshkruhen qartë, duke treguar ndikimin tek emetuesi apo titulli;
 - e) Paraqiten të ndarë në kategori sipas natyrës së tyre, ose në nën-kategori, sipas rastit.
- 3. Faktorë e rrezikut me efekt më lartë material renditen në fillim të çdo kategorie.

Neni 12

Nënshkrimi dhe/ose hedhja në treg e titullit të borxhit

- 1. Nëse emetuesi zgjedh të realizojë ofertën e titujve të borxhit përmes një ndërmjetësi financiar, ky i fundit duhet të plotësojë kërkesat e përcaktuara në pikën 2, të këtij neni.
- 2. Ndërmjetësi financiar është subjekti i licencuar nga Autoriteti dhe i caktuar nga emetuesi, për të kryer shërbimin e nënshkrimit, hedhjes në treg në bazë të angazhimit në transaksion, ose hedhjes në treg pa angazhim shitje.
- 3. Ndërmjetësi financiar i emëruar nga emetuesi shënohet në aktofertë.
- 4. Shoqëria komisionere dhe banka që ofron shërbime investimi, kryen hedhjen në treg të titujve të borxhit të emtuar nga ajo vetë për klientët e saj, me kusht që të ketë procedura/mekanizma të qarta dhe efektive për identifikimin, parandalimin apo administrimin e konflikteve të mundshme të interesit në lidhje me këtë proces.

Neni 13

Aplikimi për regjistrimin e aktofertës

Emetuesi depoziton aplikimin për regjistrimin e aktofertës, duke i bashkëngjitur kërkesës për regjistrim, aktofertën e përgatitur sipas parashikimeve në nenin 7, si dhe dokumentacionin përkatës sipas nenit 9, të kësaj rregulloreje.

Neni 14

Shqyrtimi i aplikimit dhe vendimi për regjistrimin e aktofertës

1. Autoriteti gjatë procesit të shqyrtimit të aplikimit për regjistrim të aktofertës, verifikon nëse oferta e titujve përfaqëson një nga rastet e parashikuara në nenin 6, të kësaj rregulloreje.
2. Pas verifikimit sipas pikës 1, të këtij neni, Autoriteti verifikon përputhshmërinë e aktofertës dhe dokumentacionit shoqërues, me kërkesat e kësaj rregulloreje.
3. Nëse gjatë verifikimit konstatohen mangësi, parregullsi apo nevojë për informacion shtesë, Autoriteti i kërkon emetuesit me shkrim ose në mënyrë elektronike, që brenda 10 (dhjetë) ditëve pune të plotësojë mangësitë apo parregullsitë.
4. Nëse emetuesi, për arsye të justifikuara nuk është në gjendje të plotësojë mangësitë apo parregullsitë brenda afatit prej 10 (dhjetë) ditëve pune, Autoriteti mund të zgjasë afatin edhe me 10 (dhjetë) ditë pune të tjera.
5. Në rastet kur emetuesi nuk është në gjendje ose nuk ka dëshirë të bëjë ndryshimet e kërkuara dhe të ofrojë informacionin shtesë, sipas parashikimeve të pikave 3 dhe 4 të këtij neni, Autoriteti ka të drejtë të refuzojë regjistrimin e aktofertës dhe të përfundojë procesin e rishikimit.
6. Afati i regjistrimit të aktofertës është brenda 30 ditë pune nga plotësimi i dokumentacionit të plotë sipas kërkesave të kësaj rregulloreje.
7. Bordi i Autoritetit merr vendim për regjistrimin e aktofertës.

Neni 15

Regjistri i aktofertave

Regjistri i aktofertave përmban të paktën:

- a) Të dhëna për emetuesin (emrin, adresën, NIPT);
- b) Lloji i titullit të borxhit;
- c) Qëllimi i ofertës;
- d) Shuma e ofertës;
- e) Monedha;
- f) Kategoria e investitorëve që u drejtohet oferta;
- g) Vendimi i Autoritetit për regjistrimin e akt-ofertës;
- h) Numri i identifikimit të titullit të borxhit.

Neni 16

Përgjegjësitë e emetuesit

1. Emetuesi, pas vendimit për regjistrimin e aktofertës, plotëson aktofertën me këto të dhëna:
 - i. Datën e vendimit të regjistrimit;
 - ii. Datën e hapjes dhe mbylljes së ofertës;

- iii. Datën e emetimit të titullit të borxhit dhe datat e kuponave; si dhe
 - iv. Numrin kombëtar/ndërkombëtar të identifikimit të titullit “ISIN”.
2. Brenda 10 ditëve pune nga mbyllja e ofertës emetuesi njofton Autoritetin mbi numrin kombëtar/ndërkombëtar të identifikimit të titulli “ISIN”, kohëzgjatjen e ofertës, datën e emetimit të titullit, vlerën dhe numrin e titujve të borxhit të nënshkruara, si dhe numrin e investitorëve sipas kategorizimit.
 3. Emetuesi mban përgjegjësi për saktësinë dhe vërtetësinë e informacioneve të paraqitura në aktofertë.
 4. Në rastin e ofertës publike të parashikuar në shkronjën “e”, të nenit 6, të kësaj rregulloreje, emetuesi publikon aktofertën në faqen zyrtare të tij, si dhe vë në dispozicion të publikut kopje fizike falas, të aktofertës.
 5. Emetuesi apo ndërmjetësi financiar detyrohet të kryejë përshtatshmërinë e klientit për titujt e borxhit të nënrenditur, obligacionet e konvertueshme, tituj që mund të thirren për shlyerje nga emetuesi para afatit të maturimit, si dhe tituj borxhi që përmbajnë elementë derivativë në strukturën e tyre, në përputhje me rregulloren në fuqi për vlerësimin e përshtatshmërisë së klientit.
 6. Në rastin e aktofertës të përcaktuar në shkronjën “b”, të nenit 6, të kësaj rregulloreje, emetuesi njofton Autoritetin pas çdo aktoferte për numrin e klientëve që kanë nënshkruar tituj borxhi të të njëjtit lloj, si rezultat i aktofertave të regjistruara në 12 muajt e fundit. Në rastin e aktofertës të përcaktuar në shkronjën “e”, të nenit 6, të kësaj rregulloreje, emetuesi njofton Autoritetin pas çdo aktoferte për shumën e nënshkruar të titujve të të njëjtit lloj, si rezultat i aktofertave të regjistruara në 12 muajt e fundit. Në rastin e emetimit të titujve në monedhë të huaj, respektimi i kërkesës së përcaktuar në shkronjën “e”, të nenit 6, të kësaj rregulloreje do të bëhet duke vlerësuar emetimin me kursin e këmbimit zyrtar të Bankës së Shqipërisë, të datës së mbylljes së ofertës.

Neni 17

Kohëzgjatja e ofertës

1. Kohëzgjatja e ofertës për emetimin e titujve të borxhit, në rastin e aktofertës të përcaktuar në shkronjën “b”, të nenit 6, të kësaj rregulloreje, është jo më shumë se 30 ditë pune, brenda afatit të vlefshmërisë së aktofertës.
2. Kohëzgjatja e ofertës për emetimin e titujve të borxhit, në rastin e aktofertës të përcaktuar në shkronjat “a”, “c”, “ç”, “d”, “dh”, të nenit 6, të kësaj rregulloreje, është jo më shumë se 90 ditë pune, brenda afatit të vlefshmërisë së aktofertës.
3. Kohëzgjatja e ofertës për emetimin e titujve të borxhit në rastin e aktofertës të përcaktuar në shkronjën “e”, të nenit 6, të kësaj rregulloreje përcaktohet nga emetuesi brenda afatit të vlefshmërisë së aktofertës.

Neni 18

Vlefshmëria e aktofertës

1. Aktoferta është e vlefshme për 12 (dymbëdhjetë) muaj nga vendimi për regjistrimin e saj.
2. Përpara fillimit të ofertës apo transhit në rastin e aktofertës bazë, emetuesi i bashkëngjit aktofertës çdo ndryshim informacioni me efekt material të paraqitur në aktofertën e regjistruar.
3. Informacioni sipas pikës 2 të këtij neni i njoftohet paraprakisht Autoritetit.

Neni 19

Realizimi i ofertës

1. Emetuesi përcakton në aktofertë vlerën minimale të nënshkrimit të titullit të borxhit, për të cilën oferta do konsiderohet e realizuar apo e përmbushur.
2. Në rast të mosplotësimit të parashikimit të pikës 1, të këtij neni, oferta konsiderohet e porealizuar apo e papërmbushur dhe shuma e nënshkruar i kthehet investitorëve.

Neni 20

Aktoferta bazë

1. Për të gjithë titujt e borxhit që emetohen në mënyrë të vazhdueshme ose të përsëritur si pjesë e një programi oferte, emetuesi mund të zgjedhë të hartojë një dokument në formën e një aktoferte bazë.
2. Aktoferta bazë përmban informacionin e nevojshëm në lidhje me emetuesin dhe të gjitha llojet e titujve të borxhit që synohet të emetohen.
3. Aktoferta bazë hartohet në mbështetje të informacionit të paraqitur në shtojcën 1, të kësaj rregulloreje, me kushtin që termat përfundimtare të titullit të borxhit të paraqiten nga emetuesi në rastin e çdo emetimi të titullit/transh, brenda periudhës së vlefshmërisë së aktofertës.
4. Termat përfundimtare do të paraqiten në formën e një dokumenti, sipas formatit të shtojcës 3, të kësaj rregulloreje dhe duhet të paraqiten në formë lehtësisht të analizueshme dhe të kuptueshme, si dhe të përmbajnë vetëm informacion lidhur me titullin.
5. Termat përfundimtare i njoftohen Autoritetit para fillimit të çdo transhi emetimi të titullit.
6. Dokumenti i përcaktuar në pikën 4, të këtij neni, mund të paraqitet si dokument më vete ose si pjesë e aktofertës bazë, por në çdo rast duhet të përmbajë një deklaratë ku të parashikohet se termat përfundimtarë, janë përgatitur në përputhje me këtë rregullore dhe duhet të lexohen së bashku me aktofertën bazë.

Neni 21

Emërimi i përfaqësuesit të zotëruesit të titullit të borxhit

1. Në rastin e emetimit të titujve të borxhit, zotëruesit e tyre caktojnë një përfaqësues, i cili është përgjegjës për përfaqësimin e interesave të tyre.
2. Brenda 3 muajve nga data e emetimit të titullit të borxhit, emetuesi njofton të gjithë zotëruesit për të drejtën e tyre për zgjedhjen e një përfaqësuesi, si dhe për datën e mbledhjes së zotëruesve.
3. Brenda 6 muajve nga data e emetimit të titullit të borxhit, mbledhja e zotëruesve cakton përfaqësuesin.
4. Në rast se në mbledhjen e zotëruesve nuk mundësohet zgjedhja e përfaqësuesit, emetuesi brenda 10 ditëve pune pas mbledhjes së zotëruesve, emëron përfaqësuesin e përzgjedhur prej tij dhe lidh kontratë me këtë të fundit.
5. Emetuesi njofton Autoritetin mbi përfaqësuesin e zotëruesve për çdo emetim apo transh, në rastin e aktofertës bazë, brenda 10 ditëve pune nga lidhja e kontratës me përfaqësuesin.
6. Shpenzimet për përfaqësuesin e zotëruesve dhe organizimin e mbledhjeve të zotëruesve mbulohen nga emetuesi.
7. Në funksionin e përfaqësuesit të zotëruesve mund të jetë: një shoqëri komisionere, bankë kujdestare, shoqëri me objekt veprimtarie konsulencë juridike, konsulencë financiare apo shoqëri e auditimit ligjor.

8. Nuk mund të zgjidhen si përfaqësues të zotëruesve administratorët, personat apo subjektet që kanë lidhje të ngushta apo konflikt interesi me emetuesin.

Neni 22

Respektimi i kërkesave të parandalimit të pastrimit të parave

Shoqëria komisionere/banka e licencuar për të kryer shërbimin e kujdestarisë, për çdo hapje llogarie titujsh, detyrohet të kryejë procesin e njohjes së klientit sipas kërkesave përcaktuara në legjisllacionin për parandalimin të pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit.

Neni 23

Emetuesi me seli jashtë Republikës së Shqipërisë

1. Emetuesi me seli jashtë Republikës së Shqipërisë mund të ofrojë tituj në Republikën e Shqipërisë duke përgatitur një aktofertë në përputhje me kërkesat e kësaj rregulloreje.
2. Nëse aktoferta apo një dokument i ngjashëm me të është regjistruar/depozituar në autoritetin kompetent të vendit të origjinës së emetuesit, Autoriteti njih aktofertën me kushtin që:
 - a) Autoriteti kompetent i vendit të origjinës së emetuesit ka nënshkruar marrëveshje bashkëpunimi me Autoritetin, në mbështetje të nenit 247, pika 1, shkronja (c) e ligjit;
 - b) Kërkesat për informacion në aktofertë duhet të jenë të barasvlershme me kërkesat për informacion të parashikuara në këtë rregullore.
3. Autoriteti regjistron aktofertën sipas parashikimit të pikës 1 të këtij neni, me kushtin që:
 - a) Autoriteti kompetent i vendit të origjinës së emetuesit ka nënshkruar marrëveshje bashkëpunimi me Autoritetin, në mbështetje të nenit 247, pika 2, shkronja (a) e ligjit, ose;
 - b) Emetimi kryhet nëpërmjet një shoqërie komisionere apo banke të licencuar nga Autoriteti për të ofruar shërbime investimi, e cila garanton vërtetësinë e informacionit që jepet në aktofertë.
4. Në rastin e pikës 3, të këtij neni, shoqëria komisionere/banka është përgjegjëse dhe subjekt i sanksioneve të parashikuara në ligj në rast të shkeljeve të kryera nga emetuesi.
5. Aktoferta ofrohet në gjuhën shqipe.

Neni 24

Dispozitë kalimtare

Aplikimet për regjistrim të aktofertës për emetimin e titujve të borxhit, të depozituara në Autoritet para hyrjes në fuqi të kësaj rregulloreje, do të trajtohen me kërkesat e rregullores në fuqi, me kusht që dokumentacioni i plotë i cili shoqëron aplikimin, të depozitohet brenda 30 ditëve nga data e aplikimit. Në rast të kalimit të këtij afati, do të zbatohen dispozitat e kësaj rregulloreje.

Neni 25

Shfuqizime

Me hyrjen në fuqi të kësaj rregulloreje, rregullorja nr. 187, datë 16.12.2020, “Për formën dhe procedurën e regjistrimit të aktofertës për emetimin e obligacioneve”, shfuqizohet.

Neni 26
Hyrja në fuqi

Kjo rregullore hyn në fuqi menjëherë

SHTOJCA 1

INFORMACIONI DHE FORMATI STANDARD I AKTOFERTËS PËR EMETIMIN E TITUJVE TE BORXHIT

Titulli i dokumentit: AKTOFERTË/AKTOFERTË BAZË PËR EMETIMIN E [LLOJI I TITULLIT]

Identiteti dhe të dhënat e kontaktit të emetuesit, duke përfshirë numrin unik të identifikimit të tij (NUIS/NIPT)

Lloji dhe klasa e titullit

Shuma e emetimit/Programi i emetimit në rast të aktofertës bazë

[Norma e interesit dhe afati i maturimit]

Audituesi ligjor

INVESTIMI NË KËTË TITULL SHOQËROHET ME DISA RREZIQE. FAKTORËT E RREZIKUT PËR EMETUESIN DHE TITULLIN E BORXHIT TË PËRSHKRUAR NË KËTË AKT-OFERTË DUHET TË LEXOHEN ME KUJDES.

DEKLARATA E EMETUESIT

Me besimin tonë maksimal dhe në bazë të gjithë informacioneve dhe të dhënave për të cilat jemi në dijeni, deklarojmë se të gjitha të dhënat dhe informacionet e paraqitura në këtë akt-ofertë janë të sakta dhe korrekte, se të dhënat për aktivet dhe pasivet, fitimet dhe humbjet, gjendjen financiare dhe operacionet e emetuesit, të të drejtave të lidhura me **[jepet lloji i titullit të borxhit]** përfaqësojnë një paraqitje të plotë dhe të vërtetë, dhe se nuk janë hequr fakte dhe të dhëna, të cilat mund të ndikonin në plotësinë dhe vërtetësinë e informacioneve.

nënshkruar nga [përfaqësuesi i autorizuar i emetuesit]

Kjo aktofertë duhet t'u shpërndahet investitorëve të synuar [të përcaktohet kategoria e investitorëve të synuar, sipas pikave të nenit 6 të kësaj rregulloreje], dhe nuk mund të riprodhohet apo përdoret për qëllime të tjera.

KREU 1 – HYRJE DHE NJOFTIME TË RËNDËSISHME PËR INVESTITORIN

Kjo aktofertë është hartuar nga [Jepet emri i Emetuesit] në përputhje me rregullat për përgatitjen e aktofertës. Ky dokument përmban informacione të rëndësishme për emetuesin, për titullin dhe qëllimin për të cilin kërkohet të emetohet ky titull borxhi. Kjo aktofertë përshkruan rreziqet që lidhen me emetuesin dhe rreziqet që lidhen me investimin në [Jepet lloji i titullit të borxhit]. Ju rekomandohet që ta lexoni dhe kuptoni plotësisht përmbajtjen e kësaj aktoferte përpara se të merrni ndonjë vendim për të investuar në këtë titull borxhi.

Të dhëna të përgjithshme për titullin e borxhit/ Përshkrim i përgjithshëm i programit të emetimit në rastin e aktofertës bazë

[Lloji i titullit, shuma e emetimit, monedha në të cilin emetohet titulli, norma e interesit, afati i maturimit dhe çmimi i emetimit]

Përgjegjësia për informacionet që përmban kjo aktofertë

Emetuesi pranon përgjegjësinë për informacionet dhe të dhënat që përmban kjo aktofertë. Informacionet janë në përputhje me faktet dhe nuk lënë pa përfshirë asnjë informacion që do të cënonte rëndësinë e kësaj akt-ofertë. Kur përdoret informacion nga burime të palëve të treta, ky informacion riprodhohet me saktësi dhe emetuesi mund të japë sqarime ku është publikuar informacioni nga pala e tretë, dhe se nuk është lënë jashtë asnjë fakt që do ta bënte informacionin e riprodhuar të pasaktë ose keqorientues. Burimi i informacioneve nga të tretë identifikohet.

Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare verifikon vetëm nëse aktoferta përmban të gjithë informacionin e kërkuar nga ligji nr. 62/2020 “Për tregjet e kapitalit” dhe kërkesat rregullatore, por nuk verifikon saktësinë apo vërtetësinë e informacioneve të paraqitura në akt-ofertë. Autoriteti nuk bën asnjë rekomandim për përshtatshmërinë e investimit në tituj për asnjë person.

Çdo investitor do të jetë përgjegjës për vendimin e tij mbështetur në informacionet që përmban kjo akt-ofertë dhe, nëse nuk është i bindur për investimin, të konsultohet me një profesionist/këshilltar të licencuar.

Në vendimin për investim, investitori mban parasysh, ose konsultohet me një profesionist/këshilltar mbi:

- njohuritë dhe përvojën e mjaftueshme për të bërë një vlerësim të titullit, përfitimet dhe rreziqet nga investimi dhe kuptueshmërinë e informacionit që përmban kjo akt-ofertë;
- burimet e mjaftueshme financiare dhe likuiditet për të përballuar rreziqet e investimit në titullin që ofrohet nga emetuesi,
- qartësinë mbi termat dhe kushtet e titullit dhe njohuritë mbi sjelljen e tregjeve financiare.

KREU 2 –FAKTORËT E RREZIKUT

Rubrika 1	FAKTORËT E RREZIKUT TË EMETUESIT
1.1	Një përshkrim i rreziqeve specifike të emetuesit Faktorët e rrezikut në kategori, si p.sh: - rreziqet e biznesit (rreziku i kreditit, rreziku i tregut, rreziku operacional,

	<p>rreziku makroekonomik, rreziku i likuiditetit, rreziku i pjesëmarrjes, rreziku i sigurisë kibernetike, etj)</p> <ul style="list-style-type: none"> - rreziqet ligjore, rregullative - rreziqet në lidhje me sektorin/industrinë ku operon emetuesi - rreziqe të përgjithshme të biznesit, përfshirë rrezikun reputacional, - rrezikun nga ndikimi i forcave madhore - Rreziqet e garantit, nëse ka - Rreziqet e lidhura me grupin, nëse është pjesë e grupit - rreziqe të tjera të vlerësuara si të rëndësishme nga emetuesi
Rubrika 2	FAKTORËT E RREZIKUT QË LIDHEN ME TITULLIN E BORXHIT
2.1	<p>Rreziqet kryesore të titullit (sipas llojit të titullit), si psh:</p> <ul style="list-style-type: none"> -Rreziku i mosshlyerjes apo i shlyerjes së pjesshme, - Rreziku i mungesës së garancisë së titullit të borxhit, - Rreziku nga luhatja e normave të interesit, kurseve të këmbimit, normës së inflacionit, - Rreziku i likuiditetit, - Rreziku që lidhet me vlerësimin e kreditit të titullit të borxhit, - Rreziku nga ndryshime të kuadrit fiskal, - Rreziku që lidhet me shumën minimale të investimit - Rreziqe të tjera të vlerësuara si të rëndësishme.

KREU 3 – TERMAT DHE KUSHTET E TITULLIT TË BORXHIT

Ky kre do të plotësohet duke përdorur si orientim formatin e paraqitur në shtojcën 2 të kësaj rregulloreje.

Këto terma dhe kushte duhet të lexohen si një format tip dhe duhet tu shtohen, sipas rastit, ato karakteristika të Titujve të Borxhit që nuk janë përfshirë në këte format tip. Ne veçanti, nëse ka, duhet të përfshihen:

- a. mardheniet juridike me garantoret, termat dhe kushtet e garancive,
- b. lloji i interesit (fiks apo variabel) dhe percaktimi i indeksimit nëse variabel,
- c. komponentet derivative,
- d. karakteristika të instrumenteve që do të njihen si detyrime të pranuar,
- e. karakteristika të instrumenteve të borxhit të varur
- f. karakteristika të tjera

KREU 4 - INFORMACIONI PËR EMETUESIN

Rubrika 1	TË DHËNA IDENTIFIKUESE PËR EMETUESIN
1.1	Emri juridik dhe tregtar
1.2	Forma juridike, data e themelimit, NIPT
1.3	Adresa e selisë qendrore dhe numri i kontaktit
1.4	Licenca, marka të përfituara.

Rubrika 2	ADMINISTRATORI/ËT DHE ANËTARËT E KËSHILLIT TË ADMINISTRIMIT/ MBIKËQYRËS
2.1	Identifikoni administratorin/ët dhe jepni shkurtimisht përgjegjësitë.
2.2	Identifikoni anëtarët e këshillit të administrimit/mbikëqyrës dhe pozicionin e tyre (kryetar, anëtar, i brendshëm, i jashtëm, i pavarur), si dhe pozicionin e punës
2.3	Kufizimet ose konflikti potencial i interesit të tyre (mes detyrimeve si anëtar i këshillit të administrimit/mbikëqyrës dhe/ ose administratorit/ëve dhe interesave të tyre private apo interesave të tjera).
Rubrika 3	STRUKTURA ORGANIZATIVE
3.1	Një përshkrim i strukturës organizative dhe funksionimit të emetuesit
3.2	Nëse emetuesi është pjesë e një grupi, një përshkrim i shkurtër i grupit dhe një listë e shoqërive të kontrolluara nga emetuesi
3.3	Qeverisja korporative e emetuesit
Rubrika 4	KAPITALI I EMETUESIT
4.1	Të dhëna për kapitalin aksionar
4.2	Lista e aksionerëve që zotërojnë më shumë se 10% të aksioneve
4.3	Marrëveshje, funksionimi i të cilave në një datë të mëvonshme mund të rezultojë në një ndryshim në kontrollin e emetuesit (p.sh. një marrëveshje kolatarali mbi aksionet)
Rubrika 5	PËRSHKRIM I PËRGJITHSHËM I AKTIVITETIT
5.1	Informacion historik mbi veprimtarinë e emetuesit
5.2	Përshkrim i veprimtarisë/ve kryesore (sipas licencës, nëse ka një të tillë)
5.3	Informacion mbi investimet në proces të emetuesit
5.4	Një përshkrim i tregjeve kryesore në të cilat konkuron emetuesi
5.5	Treguesit bazë të performancës
5.6	Tregues të performancës së emetuesit krahasuar me treguesit e tregut/industrisë ku vepron
5.7	Përshkrim i çdo trendi të njohur që prek emetuesin
Rubrika 6	INFORMACION I PËRMBLEDHURFINANCIAR
6.1	Të dhënat financiare të përmbledhura të pasqyrave financiare të audituara për 3 vitet e fundit (nëse ka), dhe të 3-mujorit më të fundit. Pasqyrat financiare i bashkëngjiten aktosertifikatës.
6.2	Të dhënat dhe gjëndja financiare e garantit, nëse ka
6.3	Deklarim mbi publikimin e raporteve dhe pasqyrave financiare
6.4	Qëllimi i përdorimit të fondeve nga emetimi
Rubrika 7	AUDITUESIT LIGJORË

7.1	Emrat dhe adresat e audituesve të emetuesit për periudhën që mbulon informacionin historik financiar dhe për periudhën në vazhdim
7.2	Jepni shpjegime, nëse audituesi/t ka dhënë dorëheqjen, shkarkuar ose nuk janë riemëruar
7.3	Konstatimet nga audituesi ligjor, nëse ka
Rubrika 8	VLERËSIM I RREZIKUT TË KREDITIT (AFTËSIA PAGUESE E EMETUESIT)
8.1	Vlerësimi i rrezikut të kreditit dhe institucioni që e ka bërë këtë vlerësim (nëse ka)
8.1	Ngjarjet e fundit lidhur me vlerësimin kreditor të emetuesit
Rubrika 9	INFORMACION I PËRGJITHSHËM STRATEGJIK DHE PERSPEKTIVA E EMETUESIT
9.1	Strategjia për të ardhmen
9.2	Objektivat financiare dhe jofinanciare të emetuesit dhe perspektiva e ardhshme
9.3	Një përshkrim i çdo problemi mjedisor, që mund të ndikojë tek emetuesi në se ka
Rubrika 10	INFORMACIONE TË TJERA
10.1	Konsiderata mbi trajtimin fiskal të obligacionit/titullit të borxhit.
10.2	Procedura gjyqësore në lidhje me gjendjen financiare të emetuesit, nëse ka [përndryshe deklaratë se nuk ka]
10.3	Kontrata apo patenta madhore me efekt material në performancën e shoqërisë
10.4	Konflikti i interesit në lidhje me ofertën e titullit/ Interesa me rëndësi materiale të personave të përfshirë në emetimin/ofertën e titullit të borxhit
10.5	Ndërmjetësi/it financiar/nënshkruesit (nëse ka), duke përfshirë termat dhe kushtet kryesore të dakordësuara. Përgjegjësitë e emetuesit dhe të nënshkruesit në lidhje me shpërndarjen e titullit. Deklaratë e nënshkruesit në lidhje me ofertën dhe licencën që zotëron. Marrëdhënia mes investitorit dhe nënshkruesit.
10.6	Përshkrimi i kushteve dhe kufizimeve në lidhje me shitjen e titullit, kategoritë e investitorëve që u drejtohet oferta
10.7	Të dhëna mbi këshilltarin financiar që ka hartuar akt ofertën (opsionale).

KREU 5 - INFORMACION MBI TITULLIN E BORXHIT DHE OFERTËN

Seksioni 1 – Informacion mbi titullin e borxhit

Rubrika 1	INFORMACION IDENTIFIKUES I TITULLIT QË DO TË EMETOHET
1.1	Përshkrim i llojit dhe klasës së titullit të borxhit që do të ofrohet

1.2	Numri kombëtar/ndërkombëtar i identifikimit (ISIN)
1.3	Vlera nominale
1.4	Monedha
1.5	Data e emetimit
1.6	Data e maturimit
1.7	Lloji i titullit (fiks/variabël/me discount ose të tjerë) Në rastin e obligacioneve variabël, deklaratë që përcakton llojin e bazës të përlllogaritjes
1.8	Norma e interesit/yield
1.9	Frekuenca e kuponit
1.10	Përlllogaritja e akrudeve (Day Count Fraction)
1.11	Një përshkrim i kufizimeve mbi kalimin e pronësisë të titullit të borxhit
1.12	Komponenti derivativ (nëse ka)
1.13	Në rastin e produkteve të strukturuar (certifikatave), të dhëna për aktivin bazë (aksione, indekse, mallra) si dhe performancën e tyre.
1.14	Të dhëna për garancinë/kolateralin, nëse titulli është i garantuar
1.15	Shlyerje fakultative nga emetuesi (nëse është e mundshme, jepen kushtet përkatëse)
1.16	Parashikime në rastin kur kërkesa për titullin mund të jetë më e lartë se oferta (metodologjia e shpërndarjes së titullit).
1.17	Statusi i titullit nga pikëpamja e radhës së shlyerjes
1.18	Të drejtat e lidhura me titullin: <ul style="list-style-type: none"> - Të drejtat themelore - E drejta e kërkesës për pagesë të menjëhershme të detyrimeve në rast të mosplotësimit të kushteve, - E drejta e padisë, - E drejta e kërkesës për fillimin e procedurave të falimentimit, - E drejta e zotëruesit të titulli për t'u njohur me aktivitetin e emetuesit, - E drejta e votimit (nëse ka)
Rubrika 2	VLERËSIMI KREDITOR I TITULLIT TË BORXHIT
2.1	Informacion mbi vlerësimin kreditor dhe institucionin që e ka bërë këtë vlerësim (nëse ka)
Rubrika 3	KUSHTET DHE KRITERET PËR OFRIMIN E TITULLIT TE BORXHIT
3.1	Kushtet për shlyerjen e detyrimeve që rrjedhin nga titulli i borxhit (angazhimet e emetuesit)
3.2	Kalendari i pagesave të kuponave
3.3	Informacion mbi vlerën minimale dhe maksimale të kërkesës, vlera për njësi, numri maksimal i njëjësive të obligacionit/titullit të borxhit
3.4	Çmimi i pritshëm me të cilën ofrohet obligacioni/titulli i borxhit
3.5	Plani i shpërndarjes
3.6	Çmimi i ofruar nga ndërmjetësi financiar (nëse aplikohet)
3.7	Shuma minimale që oferta të konsiderohet e realizuar
3.8	Shuma minimale e nënshkrimit në njësi dhe vlerë për çdo klient
Rubrika 4	PRANIMI PËR TREGTIM

4.1	Pranimi për tregtim në PSHT, POT, OTC
Rubrika 5	NGJARJE MOSPËRMBUSHJEJE DHE PËRFAQËSIMI I ZOTËRUESVE
5.1	Ngjarje mospërmbushjeje të detyrimeve që rrjedhin nga emetimi i obligacionit/titullit të borxhit.
5.2	Përfaqësimi i interesave të zotëruesve të titujve të borxhit
5.3	Mbledhja e zotëruesve të titujve të borxhit, përgjegjësitë e përfaqësuesit të zotëruesve të titujve të borxhit si dhe mënyra e zëvendësimit të përfaqësuesit në rast ndryshimi
Rubrika 6	TAKSIMI
6.1	Sqarim për trajtimin fiskal në rast të investimit në obligacione/tituj borxhi sipas legjislacionit tatimor në fuqi.

Seksioni 2- Informacion mbi ofertën

Rubrika 1	ARSYET E OFERTËS DHE PËRDORIMI I FONDEVE
1.1	Arsyet për ofertën
1.2	Përdorimi i fondeve, dhe, sipas rastit, vlerën e përlogaritur për secilin përdorim kryesor (nëse ka më shumë se një) të paraqitur në rend përparësie
Rubrika 2	KUSHTET E OFERTËS
2.1	Fillimi i periudhës për ofertën [data dhe ora përkatëse]
2.2	Mbyllja e ofertës [data dhe ora përkatëse]
2.3	Shpërndarja me ndërmjetës financiar
Rubrika 3	SHPENZIMET E OFERTËS
3.1	Shpenzimet që i ngarkohen investitorit
Rubrika 4	REGJISTRIMI DHE SHËRBIMI I KUJDESTARISË
4.1	Informacion mbi Regjistrarin/Depozitarin Qendror
4.2	Informacion mbi shërbimin e kujdestarisë
4.3	Kosto e shërbimit të kujdestarisë

SHTOJCA 2 - TERMAT DHE KUSHTET E TITULLIT TË BORXHIT(për t'u plotësuar si pjesë e aktofertës në kreun 3 të saj)

TERMAT DHE KUSHTET E TITULLIT TË BORXHIT

Shoqëria [-----], me seli në [-----], me NUIS [-----] (këtu e në vijim “**Emetuesi**”) është Emetuesi i titullit të borxhit (jepet “**Titulli i Borxhit**”) që është objekt i këtyre termave dhe kushteve (“**Kushte dhe Terma**”).

Emetimi i Titullit të Borxhit kryhet në bazë të vendimit të organit vendimmarrës të shoqërisë (Asambleja, Këshilli Drejtues) nr. datë [----] sipas të cilit Emetuesi mund të emetojë titull borxhi, [--pa/me--] garanci, në formë të dematerializuar, me vlere nominale prej [----], dhe vlere minimale investimi (nëse ka) të përcaktuar në vijim si “**Titulli i Borxhit**”).

1. PËRKUFIZIME

1.1. Përkufizime

“**Data e Emetimit**” nënkupton datën në të cilën Titujt e Borxhit janë regjistruar pranë Regjistrarit.

“**Data e Pagesës**” nënkupton çdo ditë në të cilën shuma e pagueshme bëhet e detyrueshme dhe e pagueshme në bazë të kontratës.

“**Data e Pagesës së Interesit**” ka kuptimin e përcaktuar në nenin [---] më poshtë.

“**Data e Shlyerjes**” ka kuptimin e përcaktuar në nenin [---] më poshtë.

“**Ditë Pune**” nënkupton ditën (përveç të Shtunës dhe të Dielës) në të cilën bankat tregtare janë të hapura për transaksione.

“**Dita e Parë e Pagesës së Interesit**” ka kuptimin e dhënë në nënparagrafin e nenit [---] më poshtë.

“**Kujdestari**” është subjekti përgjegjës për ruajtjen dhe administrimin e llogarive të titujve në emer të klienteve, si dhe për shlyerjet e pagesave nga dhe në favor të klientëve dhe cfarëdolloj detyrimi tjetër eventual të parashikuar nga legjislacioni në fuqi dhe/ose aktet nënligjore.

“**Ligji për Tregjet e Kapitalit**” është Ligji nr. 62, datës 14.05.2020.

“**Ligji për Mbrojtjen e të Dhënave Personale**” është Ligji nr. 9887, datë 10.03.2008, i ndryshuar.

“**Përfaqësuesi**” është përfaqësuesi i Zotëruesve të Titujve të Borxhit, i emëruar në përputhje me dispozitat e nenit [---].

“**Periudha e Interesit**” ka kuptimin e dhënë në nenin [---] më poshtë.

“**Norma e Interesit**” është norma e interesit e përcaktuar në përputhje me dispozitat e nenit [---] (*Llogaritja e Normës së Interesit*).

“**Regjistrari**” është subjekti i licencuar nga Autoriteti i Mbikqyrjes Financiare, objekti i veprimtarisë të së cilit përfshin, ndër të tjera, regjistrimin fillestar të titujve, mbajtjen e llogarive të tyre, si dhe administrimin e të dhënave për titujt sipas Ligjit për Tregjet e Kapitalit.

“**Regullorja AMF**” është Rregullorja në fuqi “Për Formën dhe Procedurën e Regjistrimit të Akt-Ofertës për Emetimin e Titujve të Borxhit” nr....., datë...

“**Shuma e Pagueshme**” është shuma e shprehur në nenin [---], e cila në varësi të rrethanave është e barabartë me shumën e interesit, ose me shumën e principalit, e detyrueshme për tu paguar nga Emetuesi në favor të Zotëruesit të Titujve të Borxhit në përputhje me këto Kushte dhe Terma.

“**Zotëruesi i Titujve të Borxhit**” është personi, i cili, mban dhe ka në zotërimin e tij Titujt e Borxhit dhe është titullar i të gjitha të drejtave në bazë të Titujve të Borxhit.

1.2. Parimet e interpretimit

Në këto Kushte dhe Terma të Titujve të Borxhit (Program i emetimit):

- a) nëse nuk përcaktohet shprehimisht ndryshe, referencat për një nen, nënparagraf ose aneks i referohen një neni, nënparagrafi ose aneksi të këtyre Kushteve dhe Termave;
- b) referencat për një ligj, rregullore, akt ose urdhër administrativ, përfshin edhe referencat për këtë ligj, rregullore, akt apo urdhër të ndryshuar, si dhe për rregulloret, aktet ose urdhrat ligjorë që i zëvendësojnë ato;
- c) termi “përfshin” ose “përfshirë” ose “në veçanti” nuk do të interpretohen për të krijuar një listë të mbyllur;
- d) titujt dhe nën-titujt në fillim të disa prej dispozitave të këtyre Kushteve dhe Termave të Titujve të Borxhit janë shtuar vetëm për lehtësi dhe nuk kanë ndikim në interpretimin e këtyre kushteve;

- e) anekset (nëse ka) bashkëlidhur këtyre Kushteve dhe Termave të Titujve të Borxhit janë pjesë përbërëse dhe integrale e tyre.

2. PËRSHKRIMI I TITUJVE TË BORXHIT

- 2.1. Çdo Titull Borxhi i emtuar në përputhje me këto Kushte dhe Terma është “titull borxhi” i Zotëruesit të Titullit të Borxhit në përputhje me përcaktimin e Ligjit për Tregjet e Kapitalit.
- 2.2. Titulli i Borxhit është i dematerializuar (nuk ka formë shkrese dhe nuk do të lëshohen certifikata në letër).
- 2.3. Titujt e Borxhit do të regjistrohen, në emër të secilit Zotërues të Titujve të Borxhit, nga Kujdestari në llogarinë e obligacioneve të Regjistrarit (llogari omnibus, ose individuale) dhe të drejtat që rrjedhin nga Titujt e Borxhit bëhen efikase nga momenti i regjistrimit përkatës.
- 2.4. Për çdo Titull Borxhi, Emetuesi deklaron dhe pranon se është debitor i Zotëruesit përkatës të titullit të borxhit dhe merr përsipër të ripaguajë në *cash* në favor të Zotëruesit të titullit të borxhit, në përputhje me statusin e këtij të fundit të përcaktuar në nenin 3 në vijim, shumën që korrespondon me vlerën nominale të një titulli borxhi, si dhe interesat, sipas termave dhe kushteve të përcaktuara në vijim.
- 2.5. Urdhrat për nënshkrimin e Titujve të Borxhit mund të jepen në përputhje dhe sipas kërkesave të “Formularit të Kërkesës për Investim në një Emetim të Ri Titulli Borxhi”, cili i është bashkangjitur AktOfertës.
- 2.6. Vlera nominale e Titullit të Borxhi është [---] (si dhe me fjalë---).
- 2.7. Minimumi i investimit në Titullin e Borxhi është [---] (si dhe me fjalë---).
- 2.8. Titulli i borxhit emetohet në Datën e Emetimit.
- 2.9. Qëllimi i emetimit të Titullit të borxhit është (psh. plotësimi i kërkesave rregullative dhe përdorimi i fondeve për kryerjen e veprimeve/ operacioneve karakteristike të aktivitetit bankar).

3. STATUSI I TITUJVE TË BORXHIT

- 3.1 Titujt e Borxhit (duke përfshirë principalin dhe interesat e tyre) janë (--përshkruaj statusin--)
- 3.2 Titujt e Borxhit (---kanë ose nuk kanë garanci).
- 3.3 Për sa i përket radhës së shlyerjes së tyre në rast të likuidimit të Emetuesit (---përshkruaj radhën e shlyerjes--)

4 INTERESI

4.1 Pagesa e Shumës së Interesit

Obligacionet/Titujt e Borxhit mbartin interesa që nga dita e mëpasme e Datës së Emetimit (përfshirë) deri në Datën e Shlyerjes (duke përjashtuar Datën e Shlyerjes). Në secilën datë të pagesës së interesit të përcaktuar në nenin 4.3 (“**Data e Pagesës së Interesit**”), secili Zotërues i Obligacioneve/Titujve të Borxhit do të ketë të drejtën të marrë shumën e interesit të llogaritur në përputhje me këtë nen.

4.2 Periudhat e Interesit

Periudha e interesit është një periudhë nga dita e mëpasme e Datës së Emetimit (përfshirë) deri në Datën e Pagesës së Parë të Interesit (duke përjashtuar atë ditë) si dhe çdo periudhë pasuese që vazhdon nga Data e nesërme e Datës së mëparshme të Pagesës së Interesit deri në Datën e ardhshme të Pagesës së Interesit (duke përfshirë vetë datën) (“**Periudha e Interesit**”). Megjithatë Periudha e fundit e Interesit përfundon në Datën e Shlyerjes.

4.3 Datat e Pagesës së Interesit

- a) Data e Pagesës së parë të Interesit do të jetë data [---]. (“**Data e Pagesës së Parë të Interesit**”).
- b) Datat pasuese të Pagesës së Interesit do të jenë ditët sipas programit të përcaktuar në AktOferte. Data e fundit të Pagesës së Interesit përkon me Datën e Shlyerjes dhe do të jetë data [---].

4.4 Maturimi i interesit

- a) Shuma e Interesit llogaritet veçmas për çdo Periudhë Interesi.
- b) Kur Shuma e Interesit llogaritet në përputhje me këto Kushte dhe Terma të Titujve të Borxhit për një periudhë më të shkurtër se Periudha e Interesit e përcaktuar fillimisht në Akt-Oferte, kjo shumë do të llogaritet, pro rata, në bazë të konvencionit [---].
- c) Në çdo rast, shumën e çdo interesi mbi Obligacionet/Titujt e Borxhit nuk do të kapitalizohet dhe nuk do të akumulohet asnjë interes mbi këtë shumë interesi.

4.5 Llogaritja e Shumës së Interesit

- a) Zotëruesi i Obligacionit/Titullit të Borxhit do të marrë interesa nga kuponat çdo [---] muaj. Shuma e kuponit llogaritet duke aplikuar mbi vlerën nominale normën e interesit.
- b) Formula për llogaritjen e kuponit të plotë [---]muajor është si më poshtë:
[---përfshi formulën---]
- c) Norma e Interesit për një Periudhë të caktuar Interesi do të përcaktohet në Akt-Oferte (në përputhje me llojin përkatës të Obligacioneve/Titujve të Borxhit që ka nënshkruar dhe paguar Zotëruesi i Obligacioneve/Titujve të Borxhit).

5. PAGESA E TITUJVE TË BORXHIT

- 5.1 Me kusht që të jetë dhënë informacioni i lidhur me nenin 5.5 më poshtë, shuma e pagueshme paguhet pa ndonjë kërkesë, udhëzim dhe deklaratë shtesë të Zotëruesit të Titujve të Borxhit në afatet e përcaktuara në Akt-Ofertë.
- 5.2 Nëse data e pagesës së shumës së pagueshme nuk është Ditë Pune, pagesa do të kryhet në Ditën tjetër të Punës që pason këtë ditë.
- 5.3 Çdo pagesë për llogari të Titujve të Borxhit i nënshtrohet ligjeve në fuqi në ditën e pagesës.
- 5.4 Çdo pagesë për llogari të Titujve të Borxhit në favor të Zotëruesve të Titujve të Borxhit do të bëhet nëpërmjet Kujdestarit.
- 5.5 Informacioni rreth numrit të llogarisë bankare dhe çdo informacion e dokument tjetër për të mundësuar teknikisht pagesat për llogari të Titujve të Borxhit, do të dërgohet nga Zotëruesi i Titujve të Borxhit brenda afateve të arsyeshme që lejojnë kryerjen e këtyre pagesave, nëpërmjet formularit përkatës. Për shmangien e dyshimit, mospagesa e Shumës së Pagueshme ndaj Zotëruesit të Titujve të Borxhit që rezulton nga mosparaqitja e informacionit të përmendur në këtë nen nga ana e Zotëruesit të Titujve të Borxhit nuk do të përbëjë bazë për dëmshpërblim për shkak mospagese ose vonesë ose mospërbushje të Emetuesit dhe nuk do të përbëjë bazë për asnjë përgjegjësi të Emetuesit ndaj Zotëruesit të Titujve të Borxhit.
- 5.6 Në momentin e emëtimit Emetuesi do të përcaktojë një Kujdestar fillestar i cili do të bëjë të mundur pagesën e Titujve të Borxhit nga Zotëruesit e Titujve të Borxhit sipas kushteve të punës të rregulluara nga kontrata përkatëse. Menjëherë pas Datës së Emetimit, në çfarëdoqë momenti, secili Zotërues i Titujve të Borxhit ka të drejtë të ndryshojë Kujdestarin, në përputhje me procedurat dhe praktikën e përcaktuara nga Regjistrari dhe/ose të Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare. Ky transferim i kujdestarisë mund të jetë efektiv vetëm pasi të jenë përmbushur të gjitha dhe secili nga kriteret dhe kushtet e përcaktuara nga dispozitat rregullatore, herë pas here, në fuqi. Në rast dyshimi ose paqartësie, do të prezumohet se ndryshimi i kujdestarisë nuk është perfeksionuar ende dhe, si rrjedhim, nuk është ende efektiv. Emetuesi nuk ka asnjë përgjegjësi në lidhje me transferimin e kujdestarisë. Në cdo rast, është shprehimisht e përjashtuar përgjegjësia e Emetuesit kundrejt investitorit, kujdestarit, Depozitarit Qendror/ Registrarit në lidhje me cdo veprim ose mosveprim të tij të lidhur me ose që derivon nga sa më sipër, me përjashtim të rastit kur këto veprime ose mosveprime janë shkaktuar nga Emetuesi me dashje ose faj të rëndë në shkelje të hapur të dispozitave rregullatore në fuqi.

6. SHLYERJA E TITUJVE TË BORXHIT

- 6.1 Titujt e Borxhit do të shlyen nga Emetuesi në ditën e fundit të përcaktuar në Akt-oferte (“**Data e Shlyerjes**”).
- 6.2 Në Datën e Shlyerjes, Emetuesi do të paguajë Shumën e Pagueshme për çdo Titull Borxhi, duke përfshirë principalin dhe shumën e interesave për Periudhën e fundit të Interesit.
- 6.3 Procedurat e shlyerjes së Titujve të Borxhit sipas këtyre dispozitave do të bëhet në përputhje me aktet nenligjore eventuale ose kontraktuale përkatëse.

7. TAKSAT

- 7.1 Çdo pagesë për llogari të Titujve të Borxhit do të bëhet duke marrë parasysh legjislacionin tatimor në fuqi.
- 7.2 Nëse në bazë të ligjit të aplikueshëm në të ardhmen, pagesat për llogari të Titujve të Borxhit do të sillnin në ngarkim të Emetuesit detyrimin për të mbajtur dhe paguar që në burim taksat apo detyrime të tjera tatimore, të çfarëdoqë, për llogari të Zotëruesit të Titujve të Borxhit, Emetuesi është i autorizuar ta kryejë këtë (nëpërmjet Kujdestarit) dhe nuk do të jetë i detyruar t'i paguajë Zotëruesit të Titujve të Borxhit asnjë shumë si kompensim për tatimet, taksat apo detyrimet e tjera tatimore të mbajtura dhe paguara që në burim në bazë të ligjit të aplikueshëm në fuqi.

8. DEKLARATA DHE GARANCI TË EMETUESIT

8.1 Emetuesi deklaron se:

- (a) Emetuesi është një shoqëri [---] e themeluar rregullisht dhe e ushtron aktivitetin e tij në përputhje me licencën dhe legjislacionin shqiptar në fuqi;
- (b) Emetuesi ka ose do të ketë autorizimet dhe miratimet e nevojshme të organeve të tij vendimmarrëse në lidhje me emetimin e Titujve të Borxhit;
- (c) Detyrimet e Emetuesit në lidhje me Titujt e Borxhit do të kryhen në përputhje me legjislacionin në fuqi;
- (d) Çdo informacion, i cili u është paraqitur Zotëruesve të Titujve të Borxhit nga ana e Emetuesit është i plotë dhe i saktë në të gjitha aspektet thelbësore dhe nuk përmban asnjë deklaratë të paligjshme ose të pavërtetë;
- (e) Pasqyrat financiare të Emetuesit janë përgatitur konform ligjit dhe në përputhje me standartet më të mira të kontabilitetit të aplikuar në Shqipëri dhe reflektojnë në mënyrë korrekte situatën financiare, asetet dhe të ardhurat e Emetuesit.
- (f) Në dijeninë e Emetuesit, nuk ka asnjë padi ose proces gjyqësor, aktual apo të mundshëm, i cili mund të çenojë në mënyrë thelbësore, të rëndë dhe të parikuperueshme përmbushjen e detyrimeve që

- burojnë nga Titujt e Borxhit nga ana e Emetuesit.
- (g) Emetuesi nuk ndodhet në gjendje paaftësie paaguese dhe ndaj tij nuk janë hapur procedura likuidimi vullnetar apo likuidimi të detyruar.
- 8.2 Deklarimet e mësipërme do të konsiderohen si të përseritura në favor të Zotëruesve të Titujve të Borxhit në Datën e Emetimit të Titujve të Borxhit.
- 9. DETYRIMET E INFORMIMIT**
- 9.1 Emetuesi, deri në Datën e Shlyerjes të Titujve të Borxhit detyrohet të vendosë në dispozicion të Zotëruesve të Titujve të Borxhit – në selinë ligjore të Emetuesit – (i) pasqyrat financiare vjetore të konsoliduara dhe të audituara të Emetuesit (së bashku me opinionin e audituesit), brenda 120 ditëve nga mbarimi i një viti financiar të caktuar, (ii) si dhe statutin e emetuesit në fuqi dhe (iii) kopje të akt-ofertës, si dhe çfarëdolloj dokumenti tjetër që do t'i kërkohet shprehimisht nga legjislacioni në fuqi.
- 9.2 Publikimi në kohë në faqen e internetit, ose në formën e një raporti i bërë publik në QKB i pasqyrave financiare përkatëse dhe i dokumenteve të tjera të parashikuara në këto Kushte dhe Terma, do të konsiderohet i barazvlefshëm me vënien e tyre në dispozicion ose dorëzimin e tyre tek Zotëruesit e Titujve të Borxhit.
- 10. PËLQIMI PËR DHËNIEN E INFORMACIONIT**
- a. Çdo Zotërues i Titujve të Borxhit shpreh, në mënyrë të pakthyeshme dhe te pakushtezuar, pëlqimin e tij për të vënë në dispozicion të Emetuesit dhe subjekteve të tjera që kryejnë detyrat përkatëse në lidhje me emetimin e Titujve të Borxhit, informacion në lidhje me Zotëruesin e Titujve të Borxhit dhe në lidhje me llogarinë e tij bankare, në masën që kjo është e domosdoshme për emetimin e Titujve të Borxhit dhe për kryerjen e veprimeve të tjera të parashikuara nga këto Kushte të Titujve të Borxhit. Në veçanti, pëlqimi i dhënë në këtë nen përbën një autorizim për të përpunuar të dhënat personale të Zotëruesit të Titujve të Borxhit në kuptim të Ligjit për Mbrojtjen e të Dhënave Personale, në masën që kjo është e domosdoshme për ushtrimin e të drejtave dhe përmbushjen e detyrimeve në lidhje me emetimin e Titujve të Borxhit.
- 11. TRANSFERIMI I TË DREJTAVE NË BAZË TË TITUJVE TË BORXHIT**
- 11.1 Titujt e Borxhit dhe të drejtat që rrjedhin prej tyre mund të transferohen lirisht në përputhje me dispozitat e Ligjit nr. 62/2020 “Për Tregjet e Kapitalit.
- 11.2 Titujt e Borxhit dhe cdo transferim i tyre duhet të regjistrohen tek regjistri i titujve i cili mbahet nga Regjistrari në përputhje me natyrën e tyre dhe të parashikimeve të Ligjit mbi Tregjet e Kapitalit dhe praktikën e Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare.
- 12. FUNKSIONET E PËRFAQËSUESIT TË ZOTËRUESVE TË TITUJVE TË BORXHIT**
- 12.1 Brenda 3 muajve nga Data e Emetimit, për secilin nga Titujt e Borxhit, Emetuesi njofton Zotëruesit e Titujve të Borxhit përkatëse për të drejtën për të caktuar Përfaqësuesin e tyre përkatës nëpërmjet mbledhjes së Zotëruesve të Titujve të Borxhit e cila duhet të mbahet, jo më vonë se 6 muaj nga Data e Emetimit. Nëse mbledhja e Zotëruesve të Titujve të Borxhit (i) ka dështuar të emërojë Përfaqësuesin ose (ii) nuk është mbledhur në afatin e mësipërm, Emetuesi emëron Përfaqësuesin brenda 10 ditëve pune nga verifikimi i eventeve të mësipërme (cili verifikohet i pari) dhe ia komunikon këtë Zotëruesve të Titujve të Borxhit.
- 12.2 Përfaqësuesi vepron në interesin ekskluziv të Zotëruesve të Titujve të Borxhit si dhe nuk mund të jetë nënshkruar i Titujve të Borxhit. Nuk mund të zgjidhen, gjithashtu, si përfaqësues të Zotëruesve të Titujve të Borxhit administratorët, personat apo subjektet që kanë lidhje të ngushta apo konflikt interesi me Emetuesin.
- 12.3 Përfaqësuesi është i detyruar të veprojë si pikë kontakti midis Emetuesit dhe Zotëruesve të Titujve të Borxhit.
- 12.4 Përfaqësuesi nuk do të jetë përgjegjës ndaj Zotëruesve të Titujve të Borxhit në lidhje me pagesat e Shumave të Pagueshme nga Emetuesi, si dhe për asnjë detyrim tjetër të Emetuesit në bazë të Titujve të Borxhit, me përjashtim të rastit kur palët (duke përfshirë Përfaqësuesin) kanë rënë dakord ndryshe me shkrim.
- 12.5 Përfaqësuesi nuk vlerëson përfitimet dhe rreziqet nga investimi në Tituj Borxhi dhe nuk do të jetë përgjegjës për asnjë humbje apo dëm të pësuar nga Zotëruesit e Titujve të Borxhit në lidhje me blerjen e Titujve të Borxhit.
- 12.6 Pagesa e Përfaqësuesit është në ngarkim të Emetuesit.
- 13. MBLEDHJA E ZOTËRUESVE TË TITUJVE TË BORXHIT**
- 13.1 Mbledhja e Zotëruesve të Titujve të Borxhit mbledhet për Titujt e Borxhit të një transh-i caktuar dhe thirret nga Përfaqësuesi në përputhje me parashikimet e rregullores përkatëse e cila përcakton edhe rregullat e zhvillimit dhe vendimarrjes së saj.
- 14. MODIFIKIMI KUSHTEVE DHE TERMAVE TË TITUJVE TË BORXHIT**
- 14.1 Përveç kufizimeve që rrjedhin nga dispozitat detyruese të legjislacionit perkates te aplikueshem, Kushtet dhe Termat e Titujve të Borxhit mund të ndryshohen vetem pasi të jete dhene miratimi me shkrim i Emetuesit i bazuar në propozimin e miratuar nga mbledhja e Zotëruesve të Titujve të Borxhit. Mbledhja e Zotëruesve të Titujve të Borxhit, duke përcaktuar edhe kufijtë e tagrave te ketij te fundit, mund te autorizojë Përfaqësuesin qe te negocioje me Emetuesin ndryshimin e kushteve te Titujve të Borxhit.
- 15. PARASHKRIMI I PRETENDIMEVE**

- 15.1 Parashkrimi i pretendimeve që rrjedhin nga Titujt e Borxhit ka një afat.... (përcakto afatin sipas legjislacionit në fuqi) nga momenti që lind e drejta e padisë.
- 16. NJOFTIMET**
- 16.1 Përveçse kur përcaktohet shprehimisht ndryshe, çdo njoftim i Emetuesit për Zotëruesit e Titujve të Borxhit do të jepet duke u publikuar në Faqen Web, me përjashtim të rastit kur duhet të publikohet në një formë të ndryshme në përputhje me kërkesat e legjislacionit në fuqi, duke përfshirë edhe aktet nënligjore.
- 16.2 Çdo njoftim drejtuar Emetuesit ose Përfaqësuesit do të konsiderohet se është dorëzuar, nëse është dërguar me postë rekomandë me lajmërim-marrje ose me korrier, në adresën e zyrës së përcaktuar të subjektit që i drejtohet njoftimi dhe në momentin kur subjekti që dërgon këtë njoftim merr lajmërim-marrjen.
- 17. LIGJI I ZBATUESHËM**
- 17.1 Titujt e Borxhit emetohen në përputhje me ligjin shqiptar dhe rregullohen nga ky ligj.
- 17.2 Për çdo mosmarrëveshje që mund të lindë lidhur me Titujt e Borxhit do të ketë kompetencë ekskluzive Gjykata e Shkallës së Parë, me përjashtim të rasteve kur ligji e parashikon shprehimisht dhe detyrimisht ndryshe.

SHTOJCA 3

FORMATI I TERMAVE PËRFUNDIMTARE

Termet përfundimtare të datës .../.../...
të

(shoqërisë emetuese)

Për programin e emetimit të titullit (jepet lloji i titullit) sipas Aktofertës Bazë të regjistruar me Vendimin e AMF nr. ..., datë.....

Transhi nr..

Në vlerën (jepet vlera)

QËLLIMI I TERMAVE PËRFUNDIMTARE

Ky dokument përfaqëson Termat Përfundimtare të Titullit të Borxhit të aktofertës së regjistruar sipas vendimit nr..datë (.../...) dhe duhet të lexohet e lidhur me këtë Aktofertë bazë. Informacioni i plotë mbi emetuesin dhe ofertën e titullit të borxhit/obligacionit disponohet vetëm në bazë të kombinimit të këtyre Termave Përfundimtare dhe Aktofertës Bazë.

Këto Terma Përfundimtare janë në përputhje me Programin e Emetimit të Titujve të borxhit/obligacioneve në vlerën totale (.....) të shoqërisë emetuese (.....), sipas aktofertës së regjistruar.

	Emetuesi	
	Kodi i identifikimit të titullit	
	Transhi nr.	
	Monedha	
	Vlera nominale e transhit	
	Vlera nominale për cdo njësi titulli	
	Data e emetimit	
	Data e maturimit	
	Norma e interesit	
	Datat e kuponit	
	Data e vendimit të organit drejtues të emetuesit për këtë emetim (nëse ka)	
	Të dhëna financiare të përmbledhura nga pasqyrat financiare të audituara të vitit të fundit dhe të dhënat financiare të 3-mujorit më të fundit. (Pasqyrat financiare i bashkëngjiten termave përfundimtarë)	
	Çdo informacion me efekt material	

PËRGJEGJËSIA

Emetuesi pranon përgjegjësinë për informacionin e përfshirë në këto Terma Përfundimtare.

Nënshkruar në emër të shoqërisë emetuese
(Personi përgjegjës)

SHTOJCA 4

KËRKESË PËR REGJISTRIM AKTOFERTE

DREJTUAR: AUTORITETIT TË MBIKËQYRJES FINANCIARE

(Kjo kërkesë nënshkruhet nga përfaqësuesi ligjor i autorizuar i emetuesit, ose kryetari i këshillit mbikëqyrës/administrimit)

Në cilësinë e përfaqësuesit/ kryetarit të këshillit mbikëqyrës/administrimit të shoqërisë (emri i shoqërisë) paraqes kërkesën për regjistrimin e aktofertës.

Për aq sa kam dijeni dhe besim, emetuesi:

- 1) I ka përmbushur kërkesat e Ligjit nr. 62/2020 “Për tregjet e kapitalit” dhe Rregullores “Për formën dhe procedurën e regjistrimit të aktofertës për emetimin e titujve të borxhit” për bërjen e ofertës të titullit të borxhit [përcaktohet lloji i titullit]
- 2) I ka përfshirë të gjitha informacionet që kërkon Ligji nr. 62/2020 “Për tregjet e kapitalit” dhe Rregullores “Për formën dhe procedurën e regjistrimit të aktofertës për emetimin e titujve të borxhit”
- 3) I ka vënë ose do t’i vënë në dispozicion të gjitha dokumentet dhe materialet sipas kërkesës nga Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare.

Konfirmoj se nuk ka fakte të tjera të lidhura me kërkesën për regjistrimin e akt - ofertës të cilat, në dijeninë time, do të duhej t’i bëheshin të ditura AMF-së.

Gjithashtu konfirmoj se jam në dijeni:

- 1) se emetuesi është në përputhje me kërkesat rregullative për realizimin e ofertës së obligacioneve/titullit të borxhit duke përfshirë edhe vënien në dispozicion të çdo investitori të mundshëm të dokumentit të akt-ofertës;
- 2) të përgjegjësive dhe detyrimeve si përfaqësues ligjor i autorizuar i emetuesit/ose si kryetar i këshillit mbikëqyrës/administrimit të shoqërisë, për obligacionet/titujt e borxhit që po emetohen;
- 3) se çfarë informacioni duhet të bëhet transparent kundrejt investitorëve të mundshëm, sipas bazës rregullative në fuqi, për t’u dhënë mundësi atyre të ndërmarrin një vendim të bazuar në informim.

Jam në dijeni se AMF, në funksion të përmbushjes së përgjegjësive të veta, mund të shkëmbejë çdo informacion përkatës me organe të tjera përgjegjëse për mbikëqyrjen e tregut financiar apo autoritete të tjera kompetente.

Nënshkruar në emër të emetuesit nga përfaqësuesi ligjor i autorizuar i emetuesit, ose kryetari i këshillit mbikëqyrës/administrimit të shoqërisë.

Emri:

Nënshkrimi:

Data:

SHTOJCA 5

FORMULARI I KËRKESËS PËR INVESTIM NË NJË EMETIM TË RI OBLIGACIONI/TITULL BORXHI

DREJTUAR : SHOQËRISË EMETUESE [EMRI I SHOQËRISË], E CILA KA EMETUAR TITULLIN E BORXHIT PER OFERTEN E (JEPET LLOJI I TITULLIT):

[JEPET LLOJI I TITULLIT, SHUMA TOTALE E EMETIMIT, NORMA E INTERESIT DHE AFATI I SHLYERJES],

Unë.....[emri i individit ose emri i investitorit institucional¹]

[Adresa, të dhënat e kontaktit dhe dokumenti i identifikimit

.....]

përmes kësaj kërkesë kërkoj të nënshkruaj

[jepet nr. i copëve] obligacione/tituj borxhi me çmim/ vlere nominale lekë/monedhë

tjetër/për copë të shoqërisë [jepet emri i shoqërisë emetuese]

¹ Nëse është investitor institucional, jepen të dhënat e regjistrimit të licencës nga autoriteti përkatës.

Kjo kërkesë bëhet nëpërmjet (emri dhe adresa e ndërmjetësit financiar) - nëse shpërndarja bëhet nga ndërmjetësi financiar.

.....

Janë paguar’000 lekë në lidhje me nënshkrimin në llogarinë e posaçme në bankën marrëse.

[Emri i bankës, numri dhe të dhënat e llogarisë]

Unë e kuptoj se kërkesat për investim në emetimin e mësipërm të titujve të borxhit mund të bëhen vetëm duke përdorur këtë formular kërkesë; dhe se kërkesat e bëra në mënyra të tjera nuk do të pranohen.

Unë e kuptoj se kjo ofertë i drejtohet [përcaktohet segmenti i investitorëve të mundshëm]

Ndërmjetësi financiar m’i ka shpjeguar avantazhet dhe disavantazhet e investimit në titullin e borxhit dhe më ka dhënë një kopje të udhëzuesit drejtuar investitorëve “pyetjet që bëhen më shpesh”. Ndërmjetësi financiar do të marrë (x%) komision siç kemi rënë dakord me ndërmjetësin financiar.

Mua më është dhënë një kopje e aktofertës për emetimin e lartpërmendur dhe i kam lexuar kushtet dhe risqet e përmendura në të.

Unë e kuptoj se mund të mos më caktohet sasia e plotë për të cilën është bërë nënshkrimi dhe, nëse oferta merr nënshkrime të tepërta, mund të më caktohet një sasi më e zvogëluar sipas metodës që tregohet në aktofertë.

Unë e kuptoj se do të njoftohem nga ndërmjetësi financiar lidhur me sasinë që më është caktuar pas mbylljes së ofertës.

Unë e kuptoj se obligacioni/titulli i borxhit kur të emetohet do të jetë në emrin e nënshkruesit [individ ose institucion] në formë të dematerializuar; se nuk do të lëshohen certifikata në letër dhe se do të marr njoftim kur të mbyllet oferta.

[Sa më poshtë nuk bën pjesë në formularin e kërkesës. Njoftimi që i jepet investitorit duhet të përmbajë udhëzime se çfarë mund të presë investitori dhe ku mund të gjejë informacione të mëtejshme. Për shembull:

- Kur do të merren pagesat e interesit
- Çfarë informacionesh të rregullta dhe të tjera mund të presë investitori
- Si të kontaktohet kujdestari/regjistri dhe si të ndryshohet shënimi në regjistrë nëse del nevoja (për shembull, kur ka ndryshim adrese)
- A mund të shiten obligacionet/titujt e borxhit dhe si
- Nëse obligacionet/titujt e borxhit do të regjistrohen në bursë, si mund të gjendet çmimi
- Çfarë duhet bërë nëse investitori do të donte ta kthente më herët obligacionin/titullin e obligacionit]

Nënshkruar

[emri i individit]

ose

[emri i personit të autorizuar të investitorit institucional me vulën e shoqërisë]

Formulari i plotësuar i kërkesës duhet dorëzuar (vetëm gjatë orarit normal të punës) në adresën e ndërmjetësi financiar ose këshilltarit të emetimit ose bankës marrëse në mënyrë që të merret jo më vonë se [ora] më [data].

[Këtu futet lista e adresave ku të dërgohet formulari i kërkesës]

.....

.....

SHTOJCA 6

DEKLARATË – TIP

Unë i/e nënshkruari/a (emër mbiemër), shtetas/e....., lindur më datë/...../....., në , banues/e në , madhor me zotësi të plotë juridike për të vepruar, identifikuar me dokumentin identifikues nr....., me vullnetin tim të lirë e të plotë, në dijeni të plotë të pasojave që sjell një deklaram i pavërtetë, nën përgjegjësinë time personale deklaroj se:

E njoh obligacionin/titullin e borxhit (jepet lloji i titullit) dhe marr përsipër të gjitha rreziqet që mund të shkaktohen nga investimi dhe jam i informuar se obligacioni/titulli i borxhit (lloji i titullit), nga pikëpamja e radhës së pretendimeve të shlyerjes është pas (jepet radha e shlyerjes së obligacionit/titullit të borxhit)

(Në rastin e obligacionit të nënrenditur, Deklarata –tip përshtatet për rreziqet që ka ky instrument kompleks, si dhe për pasojat që rrjedhin nga Ligji nr. 133/2016 “Për rimëkëmbjen dhe ndërhyrjen e jashtëzakonshme në banka, në Republikën e Shqipërisë”, në rastin kur emetues i obligacionit të nënrenditur janë bankat.)

Data e nënshkrimit

DEKLARUESI

(Emër, Mbiemër)